

Botim

1

DISKUTIM PËR QEVERISJE TË MIRË

Beteja Kundër Korrupsionit

BABADIMRI

AKSIONI QYTETAR FOL'08

Babadimri

© Aksioni Qytetar FOL'08

Rruga "Bedri Pejani" 7/A, 10 000 Prishtinë, Kosovë
+381(0) 38 248 677 | + 377 (0)44 324 377
www.fol-08.org | info@fol-08.org

FOL'08 mbështetet nga:
FIQ – Forumi për Iniciativa Qytetare



Personat zyrtar nuk mund të pranojnë më shumë se 10 dhurata brenda një viti

Vlera e tyre totale nuk kalon 100€ në vit.

Korrupsioni dhe përhapja e tij e gjerë në institucionet vendimmarrëse dhe në shoqëri në përgjithësi paraqet një pengesë seriozë në zhvillimin dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian. Ky fenomen po dëmton shërbimet esenciale për qytetaret dhe po rrit në vazhdimësi shkallën e mos besimit të qytetareve ndaj institucioneve.

1Kuvendi i Republikës së Kosovës më 22 prill 2005 ka aprovuar Ligjin Kundër Korrupsionit për qëllime të mbrojtjes së rendit ligjor, demokracisë dhe të drejtave të njeriut, qeverisjes së mirë, ndershmërisë dhe drejtësisë sociale, konkurrencës, rritjes ekonomike, besimit të përgjithshëm tek institucionet publike dhe vlerat morale të shoqërisë.

Në kreun 4 të këtij ligji rregullohet një çështje shumë e rëndësishme në betejën kundër korrupsionit: Dhuratat Zyrtare. Në këtë pjesë të ligjit sanksionohen rastet kur personi zyrtar mund të pranojë dhurata. Kodi Penal i Kosovës në nenin 107, përkufizonin Personin Zyrtar si: Personin e zgjedhur ose të emëruar në një organ publik, personin e autorizuar në një organizatë biznesi se ndonjë person tjetër juridik i cili sipas ligjit a

¹ Ligji Kundër Korrupsionit 2004/34

B A B A D I M R I

ndonjë dispozite tjetër të nxjerrë në pajtim me ligjin ushtron autoritet publik dhe brenda këtij autoriteti ushtron detyra të posaçme. Personi zyrtar, sipas nenit 33.1 të Ligjit Kundër Korrupsionit nuk ka të drejtë të pranoj dhuratata apo përfitime të tjera në lidhje me ushtrimin e detyrës së tij, përveç dhuratave formale dhe dhuratave të rastit në vlerë të vogël.

Më tutje, në nenin 33.2. Dhuratata formale konsiderohet dhuratat e sjella nga përfaqësuesit e vendeve të huaja dhe organizatave ndërkombëtare gjatë vizitave dhe rasteve të tjera si dhe dhuratat e sjella në kushte të ngjashme, përderisa neni 33.3. thotë: Dhuratata të rastit në vlerë të vogël konsideron dhuratat e sjella në raste të ndryshme të jubileve të punës dhe personale, raste festash dhe raste të ngjashme dhe nuk e kalojnë vlerën 50 € ose vlera totale e tyre nuk kalon 100 € në një vit, nëse ato sillen nga i njëjti person. ²Personi zyrtar nuk mund të pranojë më tepër se 10 dhuratata të rastit brenda vitit.

Aksioni Qytetar FOL'08 për më shumë se një muaj ka kërkuar nga 5 institucione raportet për dhuratat zyrtare në mbështetje të Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare dhe kreut 4 të Ligjit Kundër Korrupsionit. FOL'08, ka bërë 5 kërkesa në drejtim të Presidencës, Kuvendit të Kosovës, Kryeministrisë, Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe Ministrisë së Minierave dhe të Energjetikes mbi raportet e tyre për dhuratat që i kanë pranuar gjatë këtij viti dhe të viteve paraprak. Nga këto 5 institucione vetëm 2 prej tyre kemi marrë përgjigjeje të cilat po ashtu nuk kanë dhënë informacione mbi kërkesën tonë.

Konkluzionet

1. Katalogët e pranimit të dhuratave formale dhe të rastit nuk janë transparent dhe FOL'08 nuk ka arritur të ketë qasje në katalogun zyrtar. Kërkesave tona nuk iu janë përgjigjur pozitivisht: Kuvendi i Republikës së Kosovës, Zyra e Presidentit të Republikës, Kryeministri i Republikës si dhe Ministria për Energji dhe Miniera.
2. Institucionet përkatëse e vështirësojnë qasjen në katalogët duke devijuar rrugën e drejt institucionale të kërkesë për qasje në këtë dokument. Zyra e Kryeministrit për të pasur qasje në katalogun e saj të pranimit të dhuratave na ka referuar tek Agjencioni Kundër Korrupsionit, përderisa të gjitha ³dhuratat

² 3.3.4 Ligji Kundër Korrupsionit

³ Neni 34.1 I Ligjit kundër korrupsionit

B A B A D I M R I

dhe vlera e tyre duhet të regjistrohen në institucionet përkatës, dhe rrjedhimisht tek ai të kërkohet qasja në dokumentin përkatës.

3. Agjencioni kundër Korrupsionit parasheh vetëm 18 Institucione që duhet të dorëzojnë katalogët e tyre në këtë agjencioni, duke përjashtuar kështu shumë institucione të tjera si; Komunat. Ligji nuk është shumë i qartë në këtë drejtim, neni 35.1. Organet publike që janë të detyruara me ligj të mbajnë katalogët e dhuratave i dërgojnë kopjet e katalogëve për vitin paraprak në Agjencioni jo më vonë se dita e fundit e marsit të vitit vijues për vitin paraprak. Mirëpo, ky nen nuk specifikon ose saktëson se cili ligj duhet të përkufizoj
4. Më tutje, institucionet e vendit nuk kanë respektuar kërkesën për regjistrimin e dhuratave, nga 18 Institucionet e parapara nga Agjencioni kundër korrupsionit që të dorëzojnë katalogët vetëm 3 iu janë përgjigjur pozitivisht⁴.

Rekomandimet

1. Agjencia Kundër Korrupsionit duhet të përfshijë në listën e vetë të institucioneve që duhet të dorëzojnë katalogët e pranimit të dhuratave edhe; komunat si dhe të gjitha organizatat e tjerë, që kanë persona zyrtar sipas nenit 107 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës
2. Afati për dorëzimin e katalogëve duhet të jetë më së largu 20 janari i vitit vijues, e jo siç është tash deri në fund të marsit duke lenë hapësirë për keqpërdorime.
3. Agjencia Kundër Korrupsionit duhet për çdo vite t'i bëj publike të gjitha dhuratat që kanë pranuar institucionet përkatëse përmes një raporti të veçanta vjetore, i cili duhet të publikohet edhe në ueb faqen e Agjencisë.

⁴ Letra e 6 Nëntorit 2008 nga Agjencioni Kundër Korrupsionit

Korrespondencat me Institucionet

Agjencia Kosovar Kundër Korrupsionit

Letra e FOL'08 – 4 Nëntor 2008

I nderuari z. Hasan Preteni, Drejtor

Sipas nenit 21 të Ligjit kundër Korrupsionit, ju i raporton Këshillit të Agjencisë çdo gjashtë muaj në lidhje me përmbajtjen dhe shtrirjen e mbikëqyrjes së pasurive si dhe për gjetjet e Agjencisë në lidhje me papajtueshmërinë, konfliktin e interesave, dhuratat dhe hetimet e përfunduara.

Në mbështetje të Ligjit për Qasje ne Dokumente Zyrtare si dhe parimeve të funksionimit të Agjencisë, respektivisht Nenit 6.1 i cili thotë se “Ushtrimi i funksioneve apo detyrave publike bëhet në mënyrë transparente dhe i përgjigjet kontrollit të publikut”, do t’ju ishim falënderues nëse do të na ofronit informacionit rreth asaj se çfarë i keni raportuar Këshillit për çështjen e Dhuratave, siç përcaktohet në Kreun 4 të Ligjit Kundër Korrupsionit .

Gjithashtu, sipas nenit 35.1 kërkohet që institucionet të dërgojnë katalogët e dhuratave tek Agjencisë. A është bërë një gjë e tillë?

Shpresojmë në përgjigjen tuaj të shpejt,

Përgjigja e Agjencisë Kundër Korrupsionit – 6 Nëntor 2008

I nderuari z. Ilazi,

Po ju shkruajmë, duke ju referuar shkresës së juaj, të pranuar me datë 06.11.2008 me numër 03-853/08, ku kërkoni informacion lidhur me zbatimin e kreut të IV, respektivisht të nenit 34 paragrafi 1 të Ligjit Kundër Korrupsionit (LKK).

Ju informojmë se në pajtim me kreun e IV të LKK-së, Agjensioni Kosovar Kundër Korrupsionit ka marrë masa konkrete për zbatimin e dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me dhuratat, fillimisht ka përgatit një katalog të veçantë për dhurata, ka përgatit udhëzimet e plotësimit të tyre, janë caktuar pikat kontaktuese nëpër institucione për

B A B A D I M R I

koordinimin e veprimeve, ku është mbajtur edhe një trajnim lidhur me mënyrën e plotësimit dhe mbajtjes së katalogut të dhuratave.

Në kuadër të kësaj, sipas nenit 35 të LKK-së të gjitha institucionet që janë të detyruara me ligj të mbajnë katalogët e dhuratave, i dërgojnë kopjet e tyre për vitin paraprak në Agjension jo më vonë se dita e fundit e marsit të vitit vijues për vitin paraprak. Sipas afatit ligjor, 3 (tri) nga 18 (tetëmbëdhjetë) institucione kanë sjell katalogët e dhuratave, ndërsa institucionet tjera, kanë njoftuar se zyrtaret e tyre nuk kanë pranuar asnjë dhuratë gjatë vitit paraprak. Ndërsa sa i përket vitit 2008, ky proces mbaron me 31 mars 2009, kur edhe zyrtaret përgjegjës që janë të obliguar të i regjistrojnë dhuratat nëpër institucionet e tyre, na dërgojnë katalogët e plotësuar, ose na informojnë se nuk kanë pranuar.

Me respekt,

Muharrem Mustafa

Shef i Divizionit për Mbikëqyrjen e Pasurive dhe Dhuratave

Përgjigja e FOL'08 – 6 Nëntor 2008

I nderuari z.Mustafa,

Ju falënderojmë për përgjigjen e juaj të shpejt në kërkesën tonë. Vlerësojmë shumë vullneti tuaj për të bashkëpunuar me Shoqërinë Civile.

Duke ju referuar përgjigjes suaj, në paragrafin e tretë ju thekson se: vetëm 3 nga 18 institucionet kanë sjellë katalogët e dhuratave. Ju lutem, a mund të na informoni se cilat janë këto 3 institucione që i kanë dërguar Katalogët dhe cilët janë 15 të tjerët që nuk e kanë bërë një gjë të tillë me arsyetimin se nuk kanë pranuar dhurata? Më tutje, nuk e kemi të qartë përse janë vetëm 18 institucione që duhet të dorëzojnë katalogët.

Sepse sipas nenit 35.1. Organet publike që janë të detyruara me ligj të mbajnë katalogët e dhuratave dërgojnë kopjet e katalogëve për vitin paraprak në Agjensionin jo më vonë se dita e fundit marsit të vitit vijues për vitin paraprak. Cilat janë ato organe që janë të detyruar me ligj ta bëjnë një gjë të tillë? A nuk duhet të përfshihen edhe Komunitat? Gjithashtu do t'ju ishëm shumë falënderues nëse do të na ofronit qasje në katalogët e dhuratave të dërguar në vitin 2007 nga Presidenca, Qeveria, Zyra e Kryetarit të Parlamentit ose të ndonjërit prej 18 institucioneve të cilët duhen të dorëzojnë katalogët.

Faleminderit për ndihmën tuaj,

Përgjigja e Agjencisë Kundër Korrupsionit

I nderuari z. Ilazi,

Ju shkruajmë lidhur me emalin e datës 06 nëntor 2008, ku ju informojmë që me kompletimin e legjislacionit në fushën anti-korrupsion, që është në proces e sipër, në mbajtjen e katalogut dhe regjistrimit të dhuratave do të përfshihen të gjitha Institucionet e Republikës së Kosovës, edhe komunat.

Me respekt,

Muharrem Mustafa

Shef i Divizionit për Mbikëqyrjen e Pasurive dhe Dhuratave

Qeveria e Republikës së Kosovës

Letra e FOL'08 – 4 Nëntor 2008

I nderuari z. Fitim Krasniqi,

Sekretar i Përhershëm

Ligji Kundër Korrupsionit i miratuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2005 në kreun 4, respektivisht në nenin 34.1 kërkohet që të gjitha dhuratat e marra dhe vlera e tyre korresponduese duhet të regjistrohen nga personi zyrtar në katalogun e dhuratave që mbahet nga organi ku personi zyrtar ushtron funksionin e tij.

Duke u bazuar në këtë nen dhe në mbështetje të Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare, kërkojmë të informohemi nëse Qeveria e Republikës së Kosovës ka të instaluar një mekanizëm të tillë të regjistrimit të dhuratave si dhe të na mundësoni qasje në regjistrin e dhuratave për vitin 2007 si dhe vitin 2008.

Shpresojmë në përgjigjen tuaj të shpejt,

Përgjigja e Zyrës së Kryeministrit - 7 Nëntor 2008



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT OF KOSOVO Zyra e Kryeministrit - Office of the Prime Minister SEKTOR I ARKIVIT - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTOR			
Numri Origjinal Original No.	02	No. Dregim Reg. No.	3925/2
Numri No.	1	Data Date	07/11/08
Prishtinë / a			

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister
Sekretari i Përhershëm -Stalni Sekretar- Permanent Secretary

z. Ramadan ILAZI,
Koordinator i Aksionit Qytetar: Fol '08

Prishtinë, 07. 11.2008

I nderuar z. Ilazi,

Ju informojmë se Zyra e Kryeministrit komfort ligjit në fuqi, disponon një mekanizëm të tillë për regjistrimin e dhuratave dhe vlerave të tyre korresponduese.

Bazuar në Ligjin Kundër Korrupsionit; neni 35, pika 35.1 Zyra e Kryeministrit është e obliguar të raportoj çdo vit në fund të muajit mars pranë Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit.

Ju njoftojmë se raportin e plote mbi regjistrimin e dhuratave dhe vlerave të tyre korresponduese mund ta keni në dispozicion në fund të muajit mars 2009 tek Agjencioni Kosovare Kundër Korrupsionit.

Sinqerisht,

Fitim Krasniqi
Sekretar i Përhershëm

Ministria e Energjisë dhe Minierave

E nderuara, znj Justina Shiroka- Pula

Ligji Kundër Korrupsionit i miratuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2005 në kreun 4, respektivisht në nenin 34.1 kërkohet që të gjitha dhuratat e marra dhe vlera e tyre korresponduese duhet të regjistrohen nga personi zyrtar në katalogun e dhuratave që mbahet nga organi ku personi zyrtar ushtron funksionin e tij.

Duke u bazuar në këtë nen dhe në mbështetje të Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare, kërkojmë të informohemi nëse ju i keni regjistruar dhuratat e pranuar nga Minatorët të cilat i keni prezantuar në një emision në Televizionin Publik të Kosovës.

Shpresojmë në përgjigjen tuaj të shpejt,

- Nuk kemi marr përgjigje nga Zyra e Presidentit -

Zyra e Presidentit të Kosovës

Letra e FOL'08 – 4 Nëntor 2008

Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës

Mr.sc. Xhavit Beqiri
Këshilltar për media dhe zëdhënës

Ligji Kundër Korrupsionit i miratuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2005 në kreun 4, respektivisht në nenin 34.1 kërkohet që të gjitha dhuratat e marra dhe vlera e tyre korresponduese duhet të regjistrohen nga personi zyrtar në katalogun e dhuratave që mbahet nga organi ku personi zyrtar ushtron funksionin e tij.

Duke u bazuar në këtë nen dhe në mbështetje të Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare, kërkohet të informohemi nëse Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës ka të instaluar një mekanizëm të tillë të regjistrimit të dhuratave si dhe të na mundësoni qasje në regjistrin e dhuratave për vitin 2007 si dhe vitin 2008.

- Nuk kemi marr përgjigje nga Zyra e Presidentit -

Kuvendi i Kosovës

Letra e FOL'08 – 4 Nëntor 2008

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Sekretari i Përhershëm

I nderuari z. Ismet Krasniqi

Ligji Kundër Korrupsionit i miratuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2005 në kreun 4, respektivisht në nenin 34.1 kërkohet që të gjitha dhuratat e marra dhe vlera e tyre korresponduese duhet të regjistrohen nga personi zyrtar në katalogun e dhuratave që mbahet nga organi ku personi zyrtar ushtron funksionin e tij.

Duke u bazuar në këtë nen dhe në mbështetje të Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare, kërkohet të informohemi nëse Kuvendi i Republikës së Kosovës ka të instaluar një mekanizëm të tillë të regjistrimit të dhuratave të pranuar nga Kryetari i Kuvendit si dhe Deputetët e Kuvendit si dhe të na mundësoni qasje në regjistrin e dhuratave për vitin 2007 si dhe vitin 2008.

Shpresojmë në përgjigjen tuaj të shpejt,

- Nuk kemi marr përgjigje nga ana e Kuvendit të Kosovës -

